Mr. Bekim Alimi

SI TA KRYEJ HAXHIN?

(Doracak rreth mënyrës së kryerjes së haxhit)

Tetor 2011

بسم الله الرحمن الرحيم

Si ta kryej haxhin

Doracak për mënyrën e kryerjes së haxhit

Tetor 2011

Mr. Bekim Alimi

Redaktor:	Mr. Rejhan Neziri
Rradhitja kompjuterike:	MSc Amir Muaremi
Design:	xmedia-design.ch
Botues:	Xhamia Wil

Parathënie

Falënderimi i takon All-llahut të Madhërishëm, salavatet më të përzemërta Muhammedit a.s., shokëve të tij dhe të gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij deri në Kijamet.

Haxhilerë të nderuar, ky është një doracak mjaft i vlefshëm dhe praktik për mënyrën se si kryhet haxhi. Sidomos për ata që për herë të parë e kryejnë haxhin, është mjaft i dobishëm. Është një orientim i vlefshëm dhe çmuar. Me këtë doracak synohet pikërisht ajo që thotë Muhammedi a.s.: "Mësoni rregullat e haxhit prej meje".

Autori ia ka arritur që, si në bazë të njohurive profesionale që i ka, po edhe në bazë të përvojës disavjeçare si udhëheqës i haxhilerëve, këto rregulla të përcjella deri te ne nga Muhammedi a.s. t'i inkorporojë shumë bukur dhe në mënyrë të kuptueshme e të lehtë brenda faqeve në vijim.

Autorit i uroj për angazhimin e palodhshëm në shërbim të Islamit, kurse juve, haxhilerë të nderuar, plot shëndet e haxh të pranuar te All-llahu Fuqiplotë.

Mr. Rejhan Neziri
Imam në Kreuzlingen, CH
05.10.2011

Hyrje

All-llahu te'ala, që ka një dhembshuri të pakufishme naj krijesave të Tij, që nga njeriu i parë, duke i dërguar secilit popull nga një pejgamber, i ka ftuar njerëzit ta çojnë në vend obligimin e tyre ibadetor ndaj Zotit Fuqiplotë. Ata që ia kanë vënë veshin kësaj thirrjeje kanë ndërtuar shumë faltore, me në krye Qabenë e ndershme.

Sipas Kur'anit fisnik, kur Ibrahimi bashkë me të birin Ismailin a.s. e ndërtuan (ose e rindërtuan) Qabenë, iu lutën All-llahut me këto fjalë: "Zoti ynë, bëna neve dyve besimtarë të sinqertë ndaj Teje dhe nga pasardhësit tanë, njerëz të bindur ndaj Teje, na i mëso rregullat e ibadetit (adhurimit) tanë dhe falna neve, vërtet Ti je që falë shumë, je mëshirues"! (el-Bekara:128) Duke iu përgjigjur kësaj duaje, Zoti ua mësoi atyre përmes melekut Xhibril mënyrën se si kryhet haxhi dhe i shpalli Ibrahimit a.s.: "Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta." (Haxh:27)

Haxhi, si shtylla e pestë e Islamit, është bërë farz në vitin e nëntë pas hixhretit, me zbritjen e ajetit 97 të sures Alu Imran: "Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit, dhe kush hyn në te, ai është i sigurt. Për hir të All-llahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.". Në po të njëjtin vit Pejgamberi a.s. e cakton Ebu Bekrin për emir (udhëheqës) të haxhit, kurse në vitin e dhjetë hixhrij ai niset vetë me mbi 100 000 haxhilerë dhe e kryen haxhin e parë dhe të vetëm të tij. Ky haxh i tij ka disa emra: "Haxhi Islam" sepse është haxhi i parë i kryer pasi bëhet farz; "Haxhi belag", sepse në këtë haxh Muhammedi a.s. në mënyrë teorike dhe praktike ua sqaron haxhilerëve muslimanë rregullat e hollësishme të haxhit; dhe "Haxhi Veda'", sepse është haxhi i parë dhe i fundit i Muhammedit a.s., me ç'rast ai përshëndetet me muslimanët për herë të fundit në këtë haxh, i këshillon ata dhe ua tregon

drejtimin që ata duhet ta ndjekin në të ardhmen.

Haxhi është një ibadet që kërkon sabër a durim të madh, sepse kërkon përmbajtje dhe abstenim nga shumë sende si me veshjen e ihrameve, po edhe më pas; kërkon ballafaqim më turmë njerëzish e me nxehtësi të motit. Prandaj edhe Muhammedi a.s. thotë: "Kush e kryen haxhin, pa mos u zënë me dikë e duke iu përmbajtur rregullave të haxhit, kthehet në familje sikur ditën që e ka lindur nëna, i pastër prej gjynaheve".

Duke dashur që këto vështirësi të haxhit të mos jenë të tilla, ose së paku t'i lehtësojmë ato, e pamë të rrugës të përgatisim një doracak/udhërrëfyes të haxhit. Insha'allah ia kemi arritur qëllimit. Allahu e pranoftë prej meje këtë vepër bashkë me haxhin tuaj të kryer vetëm për hir të Tij.

Përmbajtja

1 Qyteti i Medines 1

2 Xhamia e Pejgamberit 3

3 Si ta përshëndesim Resulullahin s.a.s. 7

4 Varrezat el-Bekia 9

5 Kodra e Uhudit 11

6 Xhamia Kibletejn 13

7 Xhamia Kuba‘ 15

8 Llojet e haxhit 17

9 Veshja e Ihramit dhe nijeti i haxhit Temett‘u 21

10 Veshja e Ihramit 23

11 Namazi me rastin e veshjes së Ihramit 25

12 Telbija-Lutja e haxhit 27

13 Ndalesat në Ihram 29

14 Qyteti i Mekkes 31

15 Qabeja **33**

16 Tavafi i Umres **35**

17 Namazi i Tavafit **43**

18 Uji zem-zem **45**

19 Sa'ji i umres **47**

20 Ruajtja apo qethja e flokëve **51**

21 Veshja e Ihramit për Haxh **53**

22 Namazi i Ihramit **55**

23 Nijeti për Haxh **57**

24 Dalja në Minna ditën e Tervijes **59**

25 Arafati **61**

26 Duaja e haxhit **63**

27 Muzdelife **67**

28 Minne - Dita e parë e Kurban-Bajramit **69**

29 Kurbani **71**

30 Ruajtja apo qethja e flokëve **73**

31 Tavafi i haxhit **75**

32 Namazi i tavafit **83**

33 Uji Zemzem **85**

34 Sa'ji i haxhit **87**

35 Gjuajtja e guralecëve të dytë - Dita e dytë e Kurban-Bajramit **91**

36 Gjuatja e guralecave të tretë - Dita e tretë e Kurban-Bajramit **93**

37 Tavafi i lamtumirës - Veda **95**

Përfundimi **97**

Kapitulli 1

Qyteti i Medines

Medina zyrtarisht njihet si El-Medinetul-muneuere, është qytet në Hixhaz, një krahinë në perëndim të Arabisë Saudite. Medina tani ka mbi 1.700.000 banorë sipas të dhënave të vitit 2010. Ky qytet më parë është njohur si Jethrib, por më vonë emri i qytetit u ndërrua në Medinetun-nebij "qyteti i të Dërguarit" ose El-Medinetul-muneuere "qyteti i shndritur", e që shkurt njihet si Medina, që do të thotë "qytet". Në Medine gjendet varri i të Dërguarit të Zotit, Muhammedit (paqja qoftë mbi të) kështu që radhitet si qyteti i dytë më i shenjtë islam pas Mekës.

Fiset çifute

Jethribi (dhe emri i mëvonshëm, Medina) për herë të parë u banua nga fiset çifute Beni Kajnuka, Beni Kurejdha dhe Beni Nadir. Thuhet se gjatë dominimit persian është titulluar në Hixhaz.

Arritja e Muhammedit a.s.

Në vitin 622, Muhammedi a.s. e la Mekkën dhe arriti në Jethrib duke ndryshuar tërësisht jetën sociale dhe politike në këtë vend. Pas arritjes së tij, qyteti gradualisht filloi të njihej si

Medina. Sipas Ibën Is'hakut, muslimanët dhe çifutët e vendit nënshkruan një marrëveshje të njohur si Kushtetuta e Medines e cila i detyronte fiset muslimane dhe çifute të bashkëpunonin mes tyre. Në këtë qytet Muhamedi a.s. ndërton së pari xhaminë Kuba, pastaj edhe xhaminë kryesore të quajtur Mesxhid en-Nebevij, pra xhaminë e Pejgamberit.

Kapitulli 2

Xhamia e Pejgamberit

Xhamia e madhe në Medine, e quajtur, Mesxhid en-Nebevij, titullohet me këtë emër ngase banorët e Medines e ndërtuan këtë objekt enkas për Pejgamberin e Allahut dhe e titulluan jo vetëm xhaminë me emrin e tij por edhe tërë qytetin.

Kjo xhami është njëra nga tri xhamitë të cilat duhet vizituar në bazë të hadithit të Resulullahit s.a.s ku thotë: "Nuk është forcuar vizita juaj (haxh apo umre) përderisa t'i vizitoni tri xhamitë, Mesxhidi Haramin (Qaben), xhaminë time dhe Mesxhi Aksanë (në Kudus)".

Ndërtimi i xhamisë

Me ardhjen e Resulullahut s.a.s. nga Mekka për në Medine, në vitin 622, besimtarët i ofruan vend për banim, kurse propozimi tjetër ishte ndërtimi i një xhamie. Atij iu ofrua një vend për ndërtim. Ky vend shtrihej në mes të qytetit të Jethribit të atëhershëm dhe ishte përafërsisht 35 m gjatësi dhe 30 m gjerësi.

Filloi ndërtimi i xhamisë me tulla të thjeshta dhe me cunga të palmave kurse pjesa e lartë, çatia, u mbulua me gjethe të palmave.

Kjo xhami gjatë historisë ka pësuar zgjerime të shumta, p.sh. në kohën e Omer ibn Hattabit r.a. është zgjeruar gati dyfish. Një zgjerim të tillë ka pasur në kohën e Osman ibn

Affanit r.a. si dhe në kohën e dinastive Emevite, Abaside dhe Osmane.

Dihet se xhamia e Resulullahit ka qenë temë kryesore edhe e familjes mbretërore, kështu që investim dhe zgjerim ka pësuar në kohën e mbretit Abdul Aziz, mbretit Fejsal dhe kjo pamje e sotme është arritur me investimin e madh të mbretit Fehd ibn Abdul Aziz, në vitin 1406 hixhrij, respektivisht 1985. Ai bëri zgjerimin e xhamisë për 100‘000 m2.

Në këtë xhami gjendet minberi i Resulullahit s.a.s., në të cilin ai ka mbajtur hutbet drejtuar besimtarëve. Ky minber ishte në skajin e djathtë të xhamisë.

Në pjesën e përparme, kah kibleja, në anën lindore të xhamisë u nda një pjesë dhe u shndërrua në vendbanim të Pejgamberit, vend ku më pas do të varroset vetë Resulullahi s.a.s., më pas Ebu Bekri dhe akoma më pas edhe Omeri r.a.

Në hadithin që transmetohet në Buharij, thotë Pejgamberi i Allahut: ”Midis minberit tim dhe shtëpisë sime gjendet një prej kopshteve të xhenetit”.

Vlera e këtij vendi është në atë se besimtari musliman tenton së paku 2 rekate namaz t’i falë aty.

Haxhilerët do të ishte mirë t‘i falin 40 namaze në këtë xhami. Vlera e një namazi në këtë xhami është sa kur vlera e 1000 namazeve në xhamitë tjera, pos Qabesë, në të cilën vlera arrin në 100 000 namaze. Nëse haxhiu nuk arrin t’i fale 40 namaze në këtë xhami, nuk do të thotë se ka mangësi në plotësimin e haxhit.

Kubeja e gjelbër

Është e njohur edhe si kubeja e kaltër si dhe kubeja e bardhë. Kjo kube është direkt mbi varrin e Muhamedit a.s. e cila u ndërtua në formë katërkëndëshe në vitin 678 hixhrij nga mbreti Kalawun. Më vonë u shndërrua në kube të rrumbullakët dhe me ngjyrë të gjelbër, ashtu sikur shihet edhe sot.

Shtyllat e xhamisë

Përderisa në kohën e Resulullahit xhamia numëronte 35 shtylla nga cungu i palmave, sot kjo xhami numëron në përgjithësi 2554 shtylla me lartësi prej 5.60 m deri në 18 m, varet nga vendndodhja e shtyllës.

Kapitulli 3

Si ta përshëndesim Resulullahin s.a.s.

Pasi që muslimani/haxhiu i fali dy rekate namaz në Rauda, kopshtin e xhenetit, niset kah ana lindore e xhamisë dhe në anën e majtë të tij i sheh tri dyer të mbyllura me hekura. Te dera e parë ndalet haxhiu dhe thotë: "Es-selamu alejke ja Resulallah, es-selamu alejke ja Habiballah, es-selamu alejke ja Hajra Halkil-lah". Mundësisht haxhiu thotë edhe: "Es-selamu 'alejke ejjuhen-Nebijju ve rahmetullahi ve berakatuhu, ve sallall-llahu 'alejke ve 'ala aalike we as'habike exhmein."

Haxhiu ec dy tre hapa më tutje dhe përshëndet edhe Ebu Bekr es Siddikun, duke thënë: "Es-selamu alejke ja Eba Bekr, Ja halifete Rasulil-lah". Ec edhe pak më andej dhe thotë: "Es-selamu alejke ja Omer, Ja halifete Rasulil-lah."

Këtu duhet patur kujdes që haxhiu mos të prek apo përkdhel hekurat apo murnat, ngase ata janë vetëm mura dhe asgjë ska të shenjtë në ta. Poashtu edhe duatë duhet bërë në drejtim të kibles e jo ka varri apo ngjajshëm.

Kapitulli 4

Varrezat el-Bekia

Përballë xhamisë se Pejgamberit, në drejtim juglindor, gjenden varrezat e Medines të quajtura BEKI'A. Këtu janë varrosur afër 10.000 sahabë të Muhamedit a.s. Haxhiu u afrohet varrezave dhe sikur që është traditë islame, i përshëndet të vdekurit me: "Es-selamu alejkum ejjuhel kubur, entumus sabikune ve nahnu lahikun", pastaj nëse i jepet mundësia i afrohet brendësirës, hyn brenda dhe lexon një Fatiha (Elhamdulilahin) dhe kështu e përfundon vizitën. E nëse nuk i jepet mundësia, e lexon Fatihanë dhe jashtë mureve të varrezave.

Kapitulli 5

Kodra e Uhudit

Në mesin e vizitave të tjera, në qytetin e Medines është e preferuar të vizitohet edhe kodra e Uhudit, në të cilën u zhvillua lufta e ashpër midis mushrikëve të Mekkes dhe muslimanëve të Medines. Kjo luftë u zhvillua me 15 Shevval të vitit të 3 hixhrij, si një hakmarrje e mushrikëve ndaj muslimanëve, për shkak të disfatës së Bedrit, që ndodhi një vit më herët.

Në këtë betejë morën pjesë 700 ushtarë këmbësorë dhe 50 kalorës nga muslimanët, por ky numër u pakësua ngase disa orë para luftës dezertoi Abdullah ibn Ubejje dhe me veti mori 1/3 e ushtarëve dhe u kthye në Medine, kurse nga ana e mushrikëve 3000 këmbësorë dhe 200 kalorës. Këtë luftë e udhëhiqte vetë Hamza, xhaxhai i Muhamedit a.s. nën direktivën e Pejgamberit.

Së pari deshi Pejgamberi i Allahut që kjo betejë të zhvillohej në qytetin e Medines, por disa persona që nuk kishin marrë pjesë në luftën e Bedrit tentonin që të dilet jashtë Medines, gjë që Pejgamberi i Allahut e pranoi.

Është me rëndësi të përmendet se Pejgamberi i Allahut e ndau ushtrinë e tij në tri grupe kryesore, në grupin e:

- muhaxhirëve, me flamurtar Mus‘ab ibn Umejrin

- fisit Evs nga Ensarët, me flamurtar Esxhed ibn Hudejrin
- fisit Hazrexh nga Ensarët, me flamurtar El Hubbab ibn Mundhiri

Pejgamberi s.a.s. i porositi ushtarët e pozicionuar në kodrinat anësore mos t'i lëshonin pozitat pa marrë parasysh se a fitojnë apo humbin luftën. Posa filloi lufta, motivimi i madh i besimtarëve bëri që të mposhtin pjesën e parë të ushtrisë mushrike. Shigjetahedhësit, të pozicionuar në kodrinat anësore e lëshuan vendin dhe u lëshuan pas pasurisë së mbetur në fushëbetejë. Në këtë moment udhëheqësi i ushtrisë mushrike, Halid ibn Velidi, i cili ende nuk e kishte pranuar Islamin, i sulmoi muslimanët nga prapa shpine, nga rruga e pasme e kodrinave me ç'rast vdiqën 71 muslimanë, kurse vetë Pejgamberi s.a.s u plagos në fytyrë.

Në këtë betejë vdes edhe Hamza ibn Abdul Mutalib, xhaxhai i Muhamedit a.s., të cilin nga një pozitë e largët e gjuan me shtizë Vahshiju. Urrejtja që kishin Mekkasit për këtë trim të rrallë, shfaqet në masakrën e Hindit, gruas së Ebu Sufjanit, e cila e masakroi trupin e pajetë të Hamzës r.a.

Në këtë vend, pra në Uhud u varrosën 71 shehid në krye me shehidin më të lartë te Allahut, Hamzën r.a.

Haxhilerët në këtë vend vizitojnë luginën ku është zhvilluar beteja, afrohen rreth varrezave dhe lexojnë një Fatiha për të vdekurit e kësaj beteje të rëndësishme në Islam.

Kapitulli 6

Xhamia Kibletejn

Ishte dita e 15-të e muajit Shaban e vitit të dytë hixhrij, respektivisht 11 shkurti i vitit 642. Pejgamberi i Allahut e vizitoi Um Beshir ibn Berra‘ ibn Marur në fisin Benu Selma. Ajo i shtroi ushqim dhe erdhi koha e drekës. Pejgamberi dhe sahabët u ngritën të falin namazin e drekës. Ata i falën dy rekate në këtë vend në drejtim të Jeruslemit, ndërkaq Muhammedit a.s. i zbriti ajeti 144 i Kur‘anit nga Sureja El Bekareh, i cili i urdhëroi muslimanët të drejtoheshin kah Qabeja. Në ajet thuhej: "Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes).."

Ky vend u shndërrua në simbol të kthimit të kibles (drejtimit të faljes në namaz), ku më vonë u ngrit një shenjë e vogël si monument me rëndësi në historinë islame. Kurse në vitin 87 hixhrij është ndërtuar një xhami, që për shkak të vendit dhe rastit, ka marrë edhe emrin "Mesxhidi Kibletejn", gjegjësisht "xhamia me dy kible".

Kjo xhami është zgjeruar dhe rindërtuar disa herë gjatë historisë. Një zgjerim i dukshëm është kryer në vitin 1931 nga mbreti Abdul Aziz si dhe në vitet e tetëdhjeta nga mbreti Fahd ibn Abdul Aziz.

Gjatë vizitës së haxhiut në këtë xhami, nuk ka ndonjë obligim të posaçëm, përpos që të falë dy rekate namaz "tehijjetul mesxhid" (namazi përshëndetës ndaj xhamisë) në drejtim të Qabesë. Nuk guxon haxhiu të fal edhe dy rekate në drejtim të Jerusalemit, ngase kjo nuk vlen më si kible.

Kapitulli 7

Xhamia Kuba‘

Xhaminë e parë të cilën e ndërtoi Pejgamberi (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) është xhamia e Kubasë në Medinën e ndritshme.

Ibn Kajjimi në librin e tij "Zad El Mead" (3/58) kur e përmend hyrjen e Pejgamberit (sal-lAllahu alejhi ve sel-lem) thotë: "Muslimanët brohoritnin tekbire në shenjë gëzimi për ardhjen e tij dhe dolën ta takonin atë. Ai vazhdoi të ecte deri sa arriti në Kuba, tek vendbanimi i fisit Beni Amr b. Avf. Ai qëndroi te ta katërmbëdhjetë net dhe e ndërtoi xhaminë e Kubasë, e cila është xhamia e parë që është ndërtuar pas shpalljes (së parë të Kur'anit)."

Sipërfaqja e vendit të përcaktuar për falje është 5035 m2. Ndërsa sipërfaqja e tërësishme të cilën e përfshin ndërtesa e xhamisë duke ia shtuar anekset përcjellëse të saj arrin në 13 500 m2.

Janë transmetuar disa hadithe nga Pejgamberi s.a.s. të cilat flasin për vlerën e namazit në xhaminë e Kubasë:

- Transmetohet nga Ibn Umeri se ka thënë: "Pejgamberi vinte deri te xhamia e Kubas çdo të shtune, herë më këmbë e herë hipur në deve." [1]

[1] Buhariu me nr: 1193 dhe Muslimi me nr: 1399.

- Dhe në një transmetim te Muslimi shënohet: "Pejgamberi vinte deri te xhamia Kuba në këmbë apo i hipur mbi kafshë bartëse dhe i falte në të dy rekate."

- Usejd b. Dhuhejr i cili ishte prej shokëve të Pejgamberit transmeton se Pejgamberi (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Namazi në xhaminë e Kubasë është si një umre." [2]

- Sehl b. Hanif transmeton se Pejgamberi (lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Ai që del gjersa të vjen te kjo xhami - xhamia e Kubasë -dhe falet në të, kjo për të është e barabartë me kryerjen e një umreje." [3]

Ndërsa për sa i përket mihrabit, në xhami nuk kishte mihrab kur u ndërtua herën e parë. Dijetarët e kanë përmendur se ndërtimi i mihrabeve në xhami ka filluar në shekullin e dytë hixhrij.

Haxhiu kështu përfundon ditët e tij në Medinen e Resulullahit dhe përgatitet për në Mekke.

[2] Shejh Albani e konsideron të saktë në Sahih Et Timidhi.

[3] Nesaiu me nr: 699 dhe Shejh Albani e konsideron të saktë në Sunen En Nesaijj.

Kapitulli 8

Llojet e haxhit

Haxhi është tre llojesh:

1. Temettu'

2. Kiran dhe

3. Ifrad

Dijetarët janë unikë në mendimin se të tri llojet e kryerjes së haxhit janë të pranuara tek Allahu teala.

Aisheja (radijallahu anha) ka treguar: "Ne u larguam nga Medina me të Dërguarin e Allahut për të kryer Haxhin e Lamtumirës. Disa prej nesh e bënë nijetin për të kryer umrën, disa të tjerë bën nijetin e tyre për të kryer haxhin bashkë me umrën, ndërsa disa të tjerë për të kryer vetëm haxhin. Pejgamberi (alejhis-selam) bëri nijetin vetëm për haxhin. Sa për ata të cilët kishin për qëllim umrën, i jepnin fund ihramit sapo mbaronin ritet e umrës. Ata të cilët synonin të ndërthurnin haxhin me umrën ose ata që synonin të kryenin vetëm haxhin, nuk i jepnin fund ihramit të tyre deri në Ditën e Kurbanit, ditën e dhjetë të Dhul-Hixhes". (Transmeton Ahmedi, Buhariu, Muslimi dhe Maliku).

Haxhi Temettu

Quhet kështu për shkak se bëhet bashkimi i umrës dhe haxhit me një pushim në mes. Temetu është kur haxhiu hyn në gjendjen e ihramit për umre gjatë ditëve të haxhit dhe bën umren e pastaj del nga gjendja e ihramit dhe hyn sërish në ihram për të kryer haxhin por nuk largohet nga Meka ose rrethina e saj deri sa të kryejë edhe haxhin.

Quhet temettu sepse haxhiu ka përparësinë e kryerjes së haxhit dhe umrës në të njëjtin udhëtim pa iu dashur që të kthehet në shtëpi. Ky haxh e obligon personin me therje të një kurbani.

Kur haxhiu arrin në Meke, ai bën tavafin dhe sa'jin për umre dhe rruan ose shkurton flokët, pastaj del nga ihrami. Më pas, në ditën e 8-te të Dhul-hixhes, ai vesh sërish ihramin vetëm për haxh dhe bën të gjitha veprimet e haxhit. Pra, temettu përfshin një umre të plotë dhe një haxh të plotë.

Haxhi Kiran - lidhja e haxhit me umren

Në këtë lloj, haxhiu deklaron nijetin e tij për të kryer haxhin dhe umrën së bashku dhe kur bën telbijen, thotë: "O Allah! Unë i përgjigjem thirrjes tënde për të kryer haxhin dhe umrën".

Në haxhin Kiran haxhiu e vesh ihramin për umre dhe haxh së bashku dhe nuk del nga gjendja e ihramit deri në ditën e kurbanit.

Ky lloj haxhi e obligon haxhiun me therjen e një kurbani.

Ifrad - Vetëm kryerja e haxhit

Ifrad do të thotë që një haxhi i cili synon të kryejë haxhin duhet të bëjë nijetin vetëm për haxh në kohën kur ndodhet në mikatin e tij. Në kohën që bën telbijen, ai duhet të thotë: Lebbejke bil-haxh! (O Allah! Unë i përgjigjem thirrjes Sate për të kryer haxhin).

Ai duhet ta mbajë rrobën e tij derisa të plotësohen të gjitha ritet e haxhit. Pastaj, nëse ky haxhi dëshiron të kryejë umrën, ai mund ta bëjë këtë.

Në haxhin ifrad haxhiu qëndron i veshur me ihram deri në ditën e kurbanit.

Lloji më i mirë i haxhit është ai temettu. Pejgamberi alejhis selam i ka këshilluar dhe nxitur sahabët e tij që të bëjnë haxhin temettu.

Kapitulli 9

Veshja e Ihramit dhe nijeti i haxhit Temett‘u

Pasi haxhilerët të arrijnë në vendin e quajtur Mikat (vendi apo kufiri i veshjes së ihramit) është e pëlqyeshme të marrin gusul dhe të lyhen me erëra të mira, po ashtu, edhe të shkurtojnë mustaqet, thonjtë si dhe të pastrojnë sqetullat dhe vendet intime, ndërsa sa i përket femrave ato nuk duhet që të parfumohen.

Pasi të kenë bërë pastrimet e sipërpërmendura mashkulli vesh një rrobë të përbërë nga dy pjesë (njëra nga mesi e teposhtë, tjetra nga mesi e lart, që quhet Ihram). Gjithashtu, është e preferuar që të mbathen sandale që nuk e mbulojnë shumë shputën e këmbës.

Mashkulli e ka të ndaluar të mbulojë kokën me gjërat që e prekin lëkurën e kokës si për shembull: kapela, skaji i ihramit, valixhet, mirëpo nëse bën hije me çadër apo duke qëndruar në automjet nuk ka problem, si dhe nëse bart valixhe mbi kokë, nuk është mëkat.

Mirëpo, nëse e mbulon kokën nga mosdija duhet që ta zbulojë atë kur t’i bie ndërmend dhe nuk është i obliguar të kompensojë. Femrat mund të veshin çfarëdo që dëshirojnë prej rrobave vetëm me kusht që mos t’ia tërheqin vëmendjen të

tjerëve.

Pas pastrimit dhe veshjes së ihramit ata duhet ta bëjnë nijetin për llojin e haxhit:

Për haxhin temetu, sikur është rasti me ne, bëhet nijeti i umres së bashku së pari dhe duhet të thuhet: "Eudhu billahi minesh shejtanir raxhim, bismil-lahir rahmanir rahim, Allahumme inni uridu umreten mutemettian ilel haxhi, Allahumme jessirhu li we tekabbel hu minni, Lebejk Allahume umreten" që do të thotë "O Allah unë iu përgjigja thirrjes Sate për umre duke ia bashkëngjitur edhe haxhin. O Zot, lehtësoma dhe pranoma".

Pastaj, haxhilerët duhet ta përsërisin lutjen e mirënjohur të haxhit: "Lebbejk, Allahume, lebbejk. Lebbejke, la sherike leke, lebbejk. Innel hamde ven ni'mete leke vel mulk, la sherike lek".

Kapitulli 10

Veshja e Ihramit

Sikur që edhe u potencua më lartë, Ihrami vishet pasi që jemi pastruar dhe parfumosur. Ihrami përbëhet nga dy pjesë, pjesa e poshtme, e cila lidhet në mjedis (bel) dhe pjesa e epërme e cila mbulon gjoksin dhe lidhet me qëllim të mos bjerë për toke.

Duhet pasur kujdes se me veshjen e Ihramit, duhet të largohen të gjitha teshat tjera.

Ihrami i gruas janë teshat të cilat i ka të veshura, kurse ajo hyn në gjendje të ihramit me nijetin e bërë. Edhe pse ajo nuk ka teshë specifike që quhet ihram, asaj i ndalohen të gjitha veprat që i ndalohen edhe burrit në ihram.

Kapitulli 11

Namazi me rastin e veshjes së Ihramit

Nuk ka transmetime të besueshme për ndonjë namaz specifik që ka falë Muhamedi a.s. me rastin e veshjes së Ihramit, mirëpo shfrytëzohet ky rast për faljen e dy rekateve nafile me rastin e hyrjes në Ihram. Ky namaz falet sikur dy rekate të namazit të sabahut dhe nuk ka ndonjë rrjedhë speciale.

Nijeti bëhet kështu: "All-llahumme inni nevejtu-l haxhxhe ve ehremtu bihi lil-lahi te'ala, All-llahumme jessirhu lî ve tekabbelhu minnî nevejtu en usal-lije lil-lahi te'ala rek'atejni sunnete-l ihrami mustekbilel kibleti - All-llahu ekber".

Përkthimi në gjuhën tonë: Zoti im, vendosa ta kryej haxhxhin dhe me atë qëllim, për hir të All-llahut, në ihrame, hyj në obligimin e haxhxhit. O Zot, lehtësoma dhe pranoje prej meje. Bëj nijet t'i falë dy reqatë sunnete të ihramit, drejtohem kah Kibla, All-llahu ekber.

Mirë është që në reqatin e parë, pas Fatihas të lexohet kaptina "Kul-jâ-ejjuhel-kafirune", e në reqatin e dytë "Kul huvall -llahu".

Zakonisht aty, në xhaminë e Dhul-Hulejfes, këndohet duaja e përgjithshme, e mandej, deri në hipje në autobus pandërprerë këndohen telbijje: Lebbejk, All-llahume, lebbejk..., dhe man-

dej vazhdohet në drejtim të Mekkes.

Kapitulli 12

Telbija-Lutja e haxhit

Telbija është lutja e mirënjohur e haxhit dhe thuhet në këtë formë: "Lebbejk, Allahume, lebbejk. Lebbejke, la sherike leke, lebbejk. Innel hamde ven ni'mete leke vel mulk, la sherike lek".

Që në gjuhën shqipe d.m.th.: "Të përgjigjem, o Zot, të përgjigjem. Ti je i pa shoq, vetëm Ty të përgjigjem, falënderimi të takon vetëm Ty. Të gjitha begatitë dhe e tërë pasuria e pushteti janë Tuat. Ti je i pashoq".

Është e pëlqyeshme që kjo lutje të përsëritet sa më shpesh dhe Allahu të përmendet sa më shumë derisa të arrihet në Qabe.

Kapitulli 13

Ndalesat në Ihram

Pas veshjes së ihramit haxhiu është duke kryer ibadetin gjatë të cilit ndalohen: qethja e flokëve, e mjekrës apo prerja e thonjve (nëse i presim pa qëllim, obligohemi me kurban, e nëse nga ta shkulim diçka gjatë fërkimit të kryes me dorë apo ngjashëm, nuk obligohemi me kompensim, por me sadaka (lëmoshë ndaj të varfërve).

Ndalohet të parfumohet trupi apo ihrami,mbulimi i kryes apo i këmbëve, ndalohet gjuetia, trembja e kafshëve në vendet ku janë duke qëndruar, këputja e bimëve të gjelbërta, marrja e sendeve të gjetura, përveç rasteve kur e din të kujt janë dhe i merr për t'ia dërguar pronarit apo policisë.

Po ashtu, është e ndaluar që muhrimi (personi në Ihram) të fejohet, të martohet, ta prek bashkëshorten me epsh apo të kryejë marrëdhënie. Është e ndaluar për femrën veshja e dorëzave apo vendosja e perçes.

Kapitulli 14

Qyteti i Mekkes

Mekka është qyteti më i njohur dhe më i rëndësishëm Islam. Këtu lindi Muhammedi a.s dhe këtu gjendet faltorja e parë në historinë e njerëzimit kushtuar All-llahut e cila quhet Ka'ba. Themelet e kësaj faltoreje i vendoi pejgamberi Ademi dhe më tej, të dërguarit e Zotit Ibrahimi dhe djali i tij Ismaili.

Ajo ka një popullsi prej 1.480.000 banorësh (sipas regjistrimit të vitit 2010). Qyteti ndodhet 81 km larg Detit të Kuq, në luginën e ngushtë me rërë të Ibrahimit dhe 277 metra mbi nivelin e detit. Meka është qyteti i shenjtë në botën islame. Çdo vit, miliona muslimanë nisen për në Mekke, me qëllim kryerjen e këtij ibadeti në Islam. Ky farz quhet Haxh. Qabeja është vendosur në këtë qytet. Meka është e mbyllur për jo-muslimanët.

Kapitulli 15

Qabeja

Qabeja gjithashtu është e njohur edhe me emrat el-Ka'betu-l Musherrefeh, apo el-Bejtu-l Atik, ose el-Bejtu-l Haram. Është një ndërtim që gjendet në brendi të hapësirës së njohur el-Mesxhidu-l Haram në qytetin Mekë të Arabisë Saudite. Qabeja dallon nga të gjitha xhamitë tjera në botë, ngase muslimanët e gjithë botës gjatë faljes së namazit kthehen në drejtim të saj.

Ndërtimi dhe rindërtimet e saj

Qabeja është ndërtuar dhe rindërtuar nga këta pejgamberë: Ademi a.s., Ibrahimi dhe Ismaili si dhe Muhamedi (paqja qoftë mbi ta). Transmetohet se Qabeja është ndërtuar nga melekët para krijimit të Ademit a.s.

Historianët dhe dijetarët janë të mendimit se Qabeja është rindërtuar diku deri ne 12 herë. Rikonstruksioni më i fundit i Qabesë është bërë në vitin 1996.

Aktualisht Qabeja është e lartë 12.75 m. Dhoma brenda Qabesë është 13 me 9 m e gjerë, kurse muret e Qabesë janë 1 m të trashë. Muret janë të gjitha prej guri. Muret brenda, në dallim nga ato jashtë, nuk janë të lustruara. Dyshemeja e dhomës qëndron 2.2 metra më lartë se vendi ku njerëzit kryejnë ritin e rrotullimit rreth Qabesë (Tavafin).

Kapitulli 16

Tavafi i Umres

Kur të arrijë haxhiu në Qabe, ndërpritet thënia e lutjes së zakonshme, telbija. Haxhiu ka kujdes që të ketë abdest për tavaf dhe hyn përmes derës së quajtur Babus-selam duke qenë i pendueshëm dhe me dëshirë që All-llahu t'ia falë. Haxhiu sapo hy në harem dhe e sheh Qabenë lexon: "Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber, Bismilahi ves salatu ves selamu ala rasulillah. Eudhu bil-lahil adhim ve bivexhhihil kerim ve sulltanihil kadim minesh shejtani rraxhim. Allahumme iftah lii ebvabe rahmetik...".

Më pas lutet çka të dëshirojë në gjuhën e tij amtare. Allahu pranon lutjet e besimtarit në çastin e shikimit të parë në Qabe.

Më pas bëhet gati për tavafin e umres dhe e bën nijetin duke thënë: All-llahumme inni urîdu tavafe bejtike-l harame fejessirhu lî ve tekabbelhu minni etufu seb'ate eshvatin tavafe-l umretil haxhi, bismilah All-llahu ekber.

Përkthimi në gjuhën shqipe: Zoti im, dua ta bëj tavaf bejtul-Haremin; andaj ma lehtëso dhe ma prano. Tavafi i umres së haxhit do t'i bëj shtatë rrotullime, bismilah All-llahu ekber.

Në çastin e fillimit të Tavafit, duhet që ndërtesën e Qabesë ta ketë në anën e majtë. Rrotullimi fillon që nga guri i zi dhe përfundon në gurin e zi. Kurse një tavaf përmban shtatë

rrotullime. Kur të fillojë me çdo rrotullim, e puth gurin e zi nëse ka mundësi e nëse për shkak të grumbullit të madh të njerëzve nuk mund ta bëjë këtë, atëherë vetëm e drejton dorën e djathë drejt tij dhe thotë: "Bismil-lah, Allahu ekber. Bismil-lah, Allahu ekber. Bismil-lah, Allahu ekber".

Vendin prej ku duhet të fillojë me rrotullimin (tavafin), pra vendi se ku gjendet guri i zi, e sheh te këndi i Qabesë në anën e majtë, kurse nëse e kthen kokën në anën e djathtë, do të shohë një dritë të gjelbër të vendosur në mur lart.

Në rrotullimin e parë rreth Qabesë, në gjuhën arabe lexohet: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmanen bike ve tessdîkan bi kitabike vefâen biahdike vet-tibâan li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sellem. Es-elukel afve vel afijete fid-dîni ved-dun'ja vel-âhireti vel feuze bil-xhenneti ven-nexhâte minen-nâri.

Që në gjuhën shqipe do të thotë: O Zot, e kryej këtë vepër duke u bazuar në besimin tim ndaj Teje, dhe duke e përforcuar besimin në librin Tënd dhe duke e plotësuar premtimin ndaj Teje dhe duke e praktikuar sunetin e Pejgamberit tënd dhe të dashurit tënd, Muhamedit salallahu alejhi ve sel-lem. Të lutem për falje, shëndet dhe fuqi në fe, në këtë botë dhe në botën tjetër ta arrijë xhennetin dhe të shpëtoj nga zjarri.

Në rrotullimin e parë, të dytë dhe të tretë, ihrami duhet të jetë në atë mënyrë që supi i krahut të djathtë të jetë i pambuluar ndërsa i majti i mbuluar.

Haxhiu shpejton gjatë kryerjes së tri rrotullimeve të para, kurse ec normal gjatë katër rrotullimeve të fundit. E prek me dorë këndin e Jemenit, natyrisht nëse i jepet mundësi, sa herë që kalon afër tij, por nuk e puth e as nuk bën shenjë nga ai.

Kur të arrihet në këndin e tretë të Qabes, te këndi i ashtuquajtur këndi i Jemenit, me dorë tregon kah ai dhe thotë: "All-llahu ekber" dhe, deri në këndin e katër të Qabes, në të cilin gjendet Haxherul-esvedi, duhet lexuar: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhabennari, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru,

bismil-lahi, All-llahu ekber.

Që në gjuhën shqipe do të thotë: Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!.

Kur të arrihet te Haxherul-esvedi, duke u drejtuar kah ai thuhet: Bismil-lahi, All-llahu ekber.

Rrotullimi i dytë

Pasi që haxhiu përshëndet me dorën e djathtë tri herë gurin e zi dhe lexon "Bismillahi, Allahu ekber", tash fillon me leximin e duasë përkatëse. Në gjuhën arabe kjo dua lexohet kështu: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâen bi'ahdike vettibâ'an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim, e'udhu bike minen-nari fe harrim luhumena ve besheretena alen-nâri, All-llahumme hadhel-bejtu bejtuke fe habbib ilejnel îmâne ve zejjin bihi kulubena ve kerrih ilejnel kufra vel fusuka vel isjâne vexh'alna miner-rashidîn.

Apo, në gjuhën tonë: Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhamedit s.a.s, kërkoj mbrojtjen Tënde nga zjarri dhe ndaloja zjarrit djegjen e mishit dhe fytyrave tona. O Zot, kjo shtëpi është e Ytja, na e bën imanin të dashur dhe zbukuroj me të edhe më shumë në zemrat tona. O Zot na mundëso t'a urrejmë kufrin dhe mëkatin (mosbindjen) dhe na udhëzo.

Në këndin e Jemenit të Qabesë, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër, ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nari, vedhilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

Që në gjuhën shqipe do të thotë: Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!

Me të arritur te Haxherul-esvedi, duke i drejtuar duart thuhet: Bismi-lahi, All-llahu ekber.

Rrotllimi i tretë

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ‘en bi‘ahdike vettiba‘an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lem, e‘udhu bike minesh-shekki ve-sh-shirki ve-n-nifaki ve suil-mendheri ve-l menkalebi fî-l mâli vel ehli vel veledi, All-llahumme inni es‘eluke ridake vel xhennete ve u‘udhu bike min sehtike ven-nari, e‘udhu bike min kul-li ma jueddi ile-l adhâbi.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të mbështetem nga dyshimi shirku, dyfytyrësia, morali i ligë, pamja e keqe dhe ndryshimet e këqija në pasuri dhe familje. O Zot, lus për kënaqësinë Tënde dhe Xhennetin. Të mbështetem nga zemërimi dhe zjarri. Të mbështetem nga gjithçka që shpie në mundime”.

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: ”All-llahu ekber”, dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fiddun‘ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina ‘adhaben-nar, ved‘hilnel xhennete me‘al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

”Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!”

Duke treguar kah Haxherul-esvedi, thuhet: ”Bismil-lahi, All-llahu ekber”.

Rrotullimi i katërt

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme imanen bike ve tesdikan bi kitabike ve vefâ‘an bi‘ahdike vettibâan li sunneti nebi-jjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lem, es‘eluke en texh‘ale min zijâretî hadhihi haxhxhen mebru-ren ve dhenben megfuren ve amelen sâlihan makbulen, jâ alimel gujubi veh‘rixhni jâ All-llahu minedh-dhulumâti ilen-nuri All-llahum-me innî es‘eluke rahmeteke ve-s-selamete min kul-li ithmin rabbî kanni‘nî bimâ razektenî ve bârik fîmâ e‘atejtenî.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të lutem që ta pranosh vizitën time, haxhxhin tim, të na falësh gabimet (dhe të na i zëvendësosh) me vepra të mira. O Njohës i sekretit! Më nxjerrë nga errësira në dritë. O Zot! Të lus për mëshirën dhe shpëtimin Tënd nga mëkatet. O Zot! Më bën të kënaqur me atë që më furnizove dhe begatoje atë që ma dhurove”.

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: ”All-llahu ekber”, dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fiddun‘ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina ‘adhaben-nar, ved‘hilnel xhennete me‘al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

”Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!”

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: ”Bismil-lahi, All-llahu ekber”.

Rrotullimi i pestë

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ‘an

bi‘ahdike vettibâ‘an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim. Es-eluke en tudhal-lileni fî dhil-like jeume lâ dhil-le il-lâ dhil-luke, All-llahumme inneke ta‘lemu sirrî ve alâ nijeti fekbel me‘dhirati ve te‘lem hâxhetî fe‘tini su-ûlî. All-llahumme mâ âlimtu minhu ve ma lam e‘lemu.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u,, të lutem që të më marrësh në hijen Tënde, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër. Vërtetë Ti i di sekretet e mia dhe gjërat publike, andaj pranoje arsyetimin tim. Ti i di nevojat e mia, andaj plotësona kërkesat. O Zot! Të mbështetem nga të gjitha fatkeqësitë e tashme dhe ato të ardhshme të cilat nuk i di.”

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: ”All-llahu ekber”, dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun‘ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina ‘adhaben-nar, ved‘hilnel xhennete me‘al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

”Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!”

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: ”Bismil-lahi, All-llahu ekber”.

Rrotullimi i gjashtë

Në gjuhën arabe bëhet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme imanen bike ve tesdikan bi kitabike ve vefâ‘en bi‘ahdike vettibâan li sunneti nebijjike ve habîbike muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim. Es‘eluke en testure auretî, All-llahumme inne leke ‘alejje hukukan kethîreten fîmâ bejnî ve be-jneke ve hukukan kethireten fîma bejnî halkike, All-llahumme mâ kâne leke min‘ha fag‘firha lî ve mâ kâne lihalkike fetehammelha annî. All-llahumme inne bejteke hadha adhîmun ve ente halîmun ve tuhibbul afve fa‘fu anni.

"Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të lutem të ma mbulosh turpin tim (mëkatet). O Zot! Në relacion ndërmjet meje dhe Teje, të kam mjaft borxh, e gjithashtu kam mjaft borxh ndërmjet meje dhe krijesave Tua. O Zot! Për të drejtën Tënde më fal. E për të drejtën e krijesave Tua merr nga unë (si borxh tëndin). E Jotja është kjo Shtëpi madhështore, e Ti je i Mëshirshëm dhe e do faljen, andaj më fal!"

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nar, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Rrotullimi i shtatë

Në gjuhën arabe bëhet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmanen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ'en bi'ahdike vettibâ'an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lim. Es'eluke-l-magfirete ver-rahmete. All-llahumme en'im alejje imânen kâmilen ve rizkan vasian ve kalben hâshian ve sihhaten ve âfijeten ve teubeten kablel meuti ve ledhete-n-nedheri ilâ vexh'hike jâ erhamer-rahimiîn. All-llahumme thebbit kul?benâ alâ dînike veel hiknî bis-salihîne.

"Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke të besuar Ty dhe duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd - Muhammedit u, të lutem për falje dhe mëshirë. O Zot, ma dhuro dhuntinë e imanit të plotë, furnizim të bollshëm, zemër të penduar,

shëndet, teube (pendim) para vdekjes dhe kënaqësinë që të të shoh Ditën e Gjykimit, o i Mëshirshmi. O Zot, na e përforco zemrën në fenë Tënde dhe më bashko me njerëz të mirë."

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nar, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Kapitulli 17

Namazi i Tavafit

Pas kryerjes së tavafit, haxhiu do të gjejë ndonjë vend të përshtatshëm që t‘i falë dy reqate namaz të tavafit të cilat janë vaxhib. Më së miri është që ato t‘i falë pas Mekami-Ibrahimit, mirëpo kjo në kohën e sotshme është e pamundshme të falim në këtë vend dy reqatë e mos t‘i pengojmë haxhilerët tjerë.

Këto dy reqatë bëhen nijet kështu: Nevejtu en usal-li lil-lahi te‘ala rek‘atejni tavafi mustekbilel kibleti. All-llahu ekber.

”Vendosa, në emër të All-llahut, duke u drejtuar kah Kibla, t’i falë dy reqate të tavafit, All-llahu ekber.”

Në reqatin e parë, pas subhanekes dhe Elhamit, lexohet sureja el-Kafirune (Kul-ja ejjuhel-kâfirun), e në të dytin pas el-Fatihas lexohet sureja Ihlas (Kul-huvall-llahu).

Kur të jepet selam, zakonisht duke u kthyer kah Kibla, lexohet duaja: All-llahumme jâ rabbel bejtil atîki i‘tik rikâbena ve rikâbe âbâinâ ve ummehatinâ ve ihvaninâ minen-nari. All-llahumme inni ‘abduke vâkifun emâme bejtike mutedhel-lilun bejne jedejke erxhû rahmeteke ve ehshâ adhâbeke jâ kadîmel ihsani. All-llahumme innî es‘eluke en tukavvije îmânî ve teda‘a vizri ve tusliha emrî ve tutahhira kalbî ve es‘elukel xhennete. Amin.

Përkthimi: ”O Zot i Qabes! Na shpëto nga zjarri, prindërit, nënat, vëllezërit dhe fëmijët tanë. O Zot, vërtetë unë jam

robi Yt dhe qëndroj para Shtëpisë Sate, i përkulur lus për mëshirën Tënde. Frikohem nga ndëshkimi Yt, o Mirëbërës i Gjithmonshëm. O Zot! Vërtetë të lutem ta përforcosh imanin tim, të ma shkarkosh barrën, të ma përmirësosh gjendjen dhe të ma pastrosh zemrën. Të lutem për Xhennet - Amin."

Kapitulli 18

Uji zem-zem

Ky ujë e ka prejardhjen që nga koha e Ismailit a.s., i cili së bashku me nënën e tij, Haxheren ishin në këtë vend dhe mbasi nuk gjetën ujë për pije, ishin shtri për toke dhe pritnin vdekjen. Papritmas nën këmbët e Ismailit, doli një shpërthim i madh i ujit. Haxherja tha, "zem zem", "ndalo, ndalo". Që nga kjo kohë Allahu e shndërroi këtë vend në luginë të shenjtë.

Sot shkojnë miliona haxhilerë atje për t'i vizituar këto vende të shenjta dhe po ashtu pinë nga uji zemzem.

Haxhiu kur fillon të pijë ujë nga ky burim fisnik, e merr gotën me dorën e djathtë dhe thotë: "Bismilahir Rahmanir Rahim", kthehet kah Qabeja dhe pi ngadalë. Është e preferuar që uji të pihet me tri ndërprerje. Gjatë pirjes së ujit Zemzem haxhiu duhet paramenduar dhe shprehur dëshirën të cilën dëshiron t'ia plotësojë All-llahu.

Tani, pasi që haxhiu e kryen Tavafin e umres së haxhit, është mirë që menjëherë të vazhdojë me sa'jin.

Kapitulli 19

Sa‘ji i umres

Haxhiu përgatitet për sa‘jin ashtu siç parapërgatitet për namaz (pra me abdest). Sa‘j quhet ecja e shpejtuar e cila fillon nga Safaja, bregu i vogël i cili gjendet diku rreth 50 m nga Qabeja, dhe zgjatë deri në Merve, në bregun tjetër shkëmbor. Ndërmjet këtyre dy brigjeve, të cilat sot janë në përbërje të Haremit, ka 375 m. Kalimi prej Safasë deri në Merve konsiderohet një qark, kurse prej Merves në Safa, i dyti dhe ashtu vazhdohet shtatë herë. Në këtë rrugë, ndërmjet dy shtyllave të shënuara, ndërmjet të cilave ka diku rreth 80 m, duhet ecur me vrap. Ky vrap për gratë nuk është obligativ.

Më parë është e nevojshme që në Safa të bëhet nijeti i sa‘jit. Nijeti në gjuhën arabe bëhet në këtë mënyrë: All-llahumme innî urîdu en ess‘â bejnes-safâ vel merveti seb‘ate eshvatin seâjel umreti lil-lahi teâla fejessirhu lî ve tekabbelhu minni. All-llahu ekber. All-llahu ekber. All-llahu ekber.

Ose përkthimi në gjuhën tonë: ”O Zot! Dëshiroj që në emrin Tënd ta kryej sa‘jin ndërmjet Safasë dhe Merves shtatë herë, në emër të sa‘jit të umres, andaj ma lehtëso dhe ma prano kryerjen. All-llahu ekber, All-llahu ekber, All-llahu ekber”.

Pastaj hyjmë në sa’j, duke pasur parasysh se ecja e parë fillon prej lindjes kah perëndimi, pra prej Safasë kah Merva. Gjatë ecjes është mirë të lexohet duaja e kunutit (Allahum

inna nesteinuke dhe ijjake, që në fund të dëgjimit të kësaj pjese mund t‘i dëgjoni edhe këto dua) e pastaj duhet të lexohet edhe ky ajet: Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim. Innes-safâ vel mervete min sheâiril-lahi, femen haxhxhel bejte eu i‘temere felâ xhunâha ‘alejhi en jettavvafe bihima ve men tetavve‘a hajren fe innall-llahe shâkirun ‘alîm.

Që në gjuhën shqipe do të thotë: ”Safa dhe Merve janë nga shenjat (për adhurim) e All-llahut, e kush e mësyn shtëpinë për haxh (Qaben për haxh), ose për umre (vizitë jashtë kohës së haxhit), nuk është mëkat për te t’i vizitojë ato dyja (të ece në ato dy vende). E kush bën ndonjë të mirë nga vullneti (jo obliguese), s’ka dyshim se All-llahu është shpërblyes i gjithëdijshëm.”

Pasi që të kalohet largësia ndërmjet Safasë dhe Merves shtatë herë, duke e kënduar për çdo herë duanë e kunutit (Allahume inna nesteinuke dhe Allahumme ijjake) dhe ajetin e lartpërmendur, haxhiu do të ndalet në Merve, mbasi hera e shtatë përfundon në këtë breg, atëherë është mirë që haxhiu ta lexojë këtë dua: El-hamdu lil-lahi rabbil ‘alemîn ves-salâtu ves-selâmu ‘ala Muhammedin ve ‘ala âlihi ve as‘habihi exhmeîn. Rabbena tekabbel minnâ hadhihil ibâdete ve‘afu annâ ve alâ tâ‘atike ve shukrike e‘innâ ve alel îmani vel islâmil kâmili teveffena ve ente râdin annâ. All-llahumme irhamnî bi terkil me‘âsî ebeden ma ebkajteni verhamnî in lâ etekel-lefe mâ lâ ja‘nînî verzuknî bimâ jurdîke annî. Jâ erhamerr-rrahimin.

Përkthimi në gjuhën tonë: ”Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve, mëshira dhe shpëtimi qoftë mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij. O Zoti ynë, pranoje këtë ibadet prej nesh dhe na falë. Na ndihmo që të jemi të dëgjueshëm dhe falënderues dhe dua të jesh i kënaqur me ne. Na mundëso vdekjen me iman të plotë dhe Islam. O Zot, më mëshiro që gjithmonë ta flak mosdëgjueshmërinë ndaj Teje, derisa të jem gjallë. Më falë (ashtu që) të mos jem i ngarkuar me atë që nuk më intereson. Më furnizo me ato me të cilën do të jesh i kënaqur, o i Gjithëmëshirshëm!”

Me kryerjen e sa‘jit përfundojnë ritualet e domosdoshme që duhet të kryhen në Mekke para daljes në Arafat. Kuptohet që haxhiu do të tentojë që të falë sa më tepër namaz në Harem, të këndojë Kur‘an apo të bëjë ibadete tjera, mirëpo e gjithë kjo është jashtë obligimeve të domosdoshme, përveç asaj që jemi të detyruar të qëndrojmë në ihram dhe nuk kemi të drejtë ta heqim. D.m.th. haxhiu duhet t‘u përmbahet rregullave që i sqaruam më parë në lidhje me ihramet dhe obligimet tjera derisa është në ihrame.

Kapitulli 20

Ruajtja apo qethja e flokëve

Haxhiu duhet të ketë kujdes të veçantë që mos ta zhveshë ihramin para se të ruhet apo të qethë flokët. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Allahu e mëshiroftë tri herë atë që e ruan kryen (ruajtjen e flokëve) dhe Allahu e mëshiroftë atë që i shkurton flokët" .

Nga ky hadith kuptojmë se haxhiu ka të drejtë edhe qethjen e flokëve, por ruajtja e flokëve është më e preferuar.

Sa i takon grave, edhe ato janë në ihram. As ato nuk guxojnë të kryejnë vepra që në ihram janë të ndaluara, derisa të shkurtojnë diçka nga flokët e tyre.

Shkurtimi i flokëve mund të bëhet edhe në vende të caktuara, por edhe haxhilerët mund t'ia qethin ose shkurtojnë flokët njeri-tjetrit, me kusht që ai që ia shkurton flokët tjetrit, të ketë dalë nga ihrami.

Në këtë rast haxhiu lirohet nga Ihrami, por me lirim të kufizuar. Ai nuk ka të drejtë të largohet nga Mekka dhe nuk ka të drejtë për marrëdhënie intime me bashkëshorten.

Me tesha normale, haxhilerët kalojnë disa ditë në Mekke, deri sa të vijë dita për në Minne.

Kapitulli 21

Veshja e Ihramit për Haxh

Sikur që edhe u potencua më lartë, Ihrami vishet pasi që jemi pastruar dhe parfumosur. Ihrami përbëhet nga dy pjesë, pjesa e poshtme, e cila lidhet në mjedis dhe pjesa e epërme e cila mbulon shpatullat dhe gjoksin dhe lidhet për mjedisi apo në anët e kundërta.

Duhet pasur kujdes se me veshjen e Ihramit, largohen të gjitha teshat tjera.

Ihrami i gruas janë teshat të cilat i ka të veshura kurse ajo hyn në gjendje të ihramit me nijetin e bërë. Edhe pse ajo nuk ka teshë specifike që quhet ihram, asaj i ndalohen të gjitha veprat që i ndalohen edhe burrit në ihram.

Kapitulli 22

Namazi i Ihramit

Nijeti bëhet kështu: "All-llahumme inni nevejtu-l haxhxhe ve ehremtu bihi lil-lahi te'ala, All-llahumme jessirhu lî ve tekabbelhu minnî nevejtu en usal-lije lil-lahi te'ala rek'atejni sunnete-l ihrami mustekbilel kibleti - All-llahu ekber".

Përkthimi në gjuhën tonë: "Zoti im, vendosa ta kryej haxhxhin dhe me atë qëllim, për hir të All-llahut, në ihrame, hyj në obligimin e haxhxhit. O Zot, lehtësoma dhe pranoje prej meje. Bëj nijet t'i falë dy reqatë sunnete të ihramit, drejtohem kah Kibla, All-llahu ekber".

Mirë është që në reqatin e parë, pas Fatihas të lexohet kaptina "Kul-jâ-ejjuhel-kafirune" , e në reqatin e dytë "Kul huvall -llahu".

Kapitulli 23

Nijeti për Haxh

Pas pastrimit dhe veshjes së ihramit ju duhet ta bëni nijetin për llojin e haxhit që dëshironi ta kryeni, pra në rastin tonë, për haxhin temetu dhe duhet të thoni: "Eudhu bil-lahi minesh shejtanir raxhim, bismil-lahir rahmanir rahim, Allahumme inni uridul haxhe, ve uhrimtu bi lilahi teala. Allahumme jessirhu lii ve tekabbel hu minni, Lebejk Allahume haxhen".

"O Allah unë iu përgjigja thirrjes Tënde për haxhin dhe e vesha ihramin në emër Tënd. O Zot lehtësoma dhe pranoma".

Pastaj, haxhiu duhet ta përsërisë lutjen e mirënjohur të haxhit: "Lebbejk Allahume lebbejk. Lebbejke la sherike leke lebbejk. Innel hamde ven nimete leke vel mulk, la sherike lek".

Është e pëlqyeshme që kjo lutje të përsëritet sa më shpesh dhe Allahu të përmendet sa më shumë derisa të gjuhen guralecët në ditën e parë.

Kapitulli 24

Dalja në Minna ditën e Tervijes

Sipas medh'hebit tonë, pra medh'hebit hanefij, qëndrimi në Arafat është njëri prej tre farzeve të haxhit, krahas Ihramit dhe Tavafit të haxhit. Në qoftë se ndodh që haxhiu të mos e kryejë një nga këto tre farze, konsiderohet se nuk e ka kryer haxhxhin.

Më tetë Dhul-hixhxheh (kjo ditë quhet edhe jeumut-tervije), zakonisht pas iqindisë, haxhilerët me autobusë dalin nga Mekka për në Mina e të nesërmen për në Arafat, që është larg afro 22 km nga Mekka.

Sunnet është që, gjatë shkuarjes në Arafat, të shkohet në Mine dhe aty të kalohet nata ndërmjet 8 dhe 9 Dhul-hixhxhes, ngase kështu veproi Muhammedi s.a.v.s. atëherë kur e bëri haxhxhin e lamtumirës. Megjithatë, kjo në ditët e sotme të kryerjes së haxhit, është gati e pamundshme nga shkaku i grumbullit të madh të haxhlerëve dhe nga shkaku se lugina e Minës është tepër e ngushtë për numrin e haxhilerëve, andaj pjesa dërmuese e haxhilerëve shkojnë direkt në Arafat.

Prandaj, haxhiu nga Mekka do të shkojë në Arafat drejtpërsëdrejti, do të vendoset në tendën e vet dhe aty do ta kalojnë ditën e nëntë të Dhul-hixhxhes, përkatësisht një ditë

para Kurban-Bajramit.

Kapitulli 25

Arafati

Rituali i qëndrimit në Arafat i ka kushtet e veta, vaxhibe dhe sunnete. Sharti për vlefshmërinë e qëndrimit në Arafat është të kryhet në kohën e caktuar, e ajo është një ditë para Bajramit. Kusht tjetër nuk ka, nijet nuk bëhet, e as që kërkohet vetëdije se qëndrohet në Arafat.

Sunnet është që haxhiu të lahet, imami i xhamisë së Arafatit t'i lexojë dy hutbet. Gjatë kohës së drekës të falen dreka dhe iqindia me një ezan. Sunnet është që haxhiu të lexojë sa më tepër Kur'an, salavate, telbijje dhe pendueshëm ta lusë All-llahun teala për falje, ngase në përmbledhjen e haditheve të Muslimit qëndron se Muhammedi s.a.v.s. ka thënë: "Nuk ka ditë që All-llahu falë nga zjarri më tepër robër, sesa ditën e Arafatit."

Atë ditë siç përmendëm, haxhiu në kohën e drekës do t'i bashkojë namazin e drekës dhe iqindisë. Në organizimin tonë falet namazi i drekës dhe i ikindisë në formë të përbashkët (pra me xhemat), në kohën e drekës, nga dy rekate dhe me një ezan dhe dy ikamete.

Kapitulli 26

Duaja e haxhit

Është bërë e zakonshme që duaja kryesore të bëhet së bashku, edhe atë para perëndimit të diellit, dhe kjo bëhet kështu edhe në grupin tonë. Ne këtu do ta theksojmë një dua për të cilën mendojmë se edhe pse është bërë duaja e përbashkët, është mirë që çdo haxhxhi ta lexojë në Arafat edhe këtë dua, mbase, siç thotë Imam Aliu r.a., një pjesë të mirë të këtyre fjalëve i ka thënë Muhammedi s.a.v.s. kur qëndroi në Arafat.

Duaja është kjo: "Eudhu bil-lahi minesh-shejtanirr-rraxhîm. Bismil-lahi- Rrahmânirr-Rrahîm. Elhamdu lil-lahi rabbil 'alemîn ves-salatu ves-selamu alâ sejjidil mureslîn. All-llahumme lekel hamdu. All-llahumme leke salâtî ve nusukî ve mehjâje ve memâti, ve ilejke meâbi All-llahumme innî e'udhu bike minel hemmi vel huzni ve e'udhu bike minel 'axhzi vel keseli ve e'udhu bike minel xhubni vel buhli, All-llahumme slih dînîl-ledhî huve 'ismetu emri ve veslih lî dun'jajel-letî fîhâ me'âshi veslih lî âhireti-letî fîhâ me'âdi vexh'al meuti râhaten min kul-li sherri, All-llahumme innî es-elukel afve vel âfijete fî dînî ve dun'jaje ve ehlâ ve mâlî. All-llahumme estiru aureti vehfidh-ni, All-llahumme-g-firlî hâtieti ve xhehli ve isrâfi fî emrî, All-llahumme-g-firlî mâ kaddemet ve ma ahhertu ve ma esrertu eamentu ve ma ente e'alemu bihi minni inneke le'alije kul-li shej'in kadîr, All-llahumme inne es'eluke-l xhennete ve ve

e‘udhu bike minen-nâre lâ ilahe il-lall-llahu vahdehu la sherîke leke lehu, lehu-l mulku ve lehu-l hamdu, All-llahumme sal-li ‘alâ muhammedin ‘ala âli Muham-medin kemâ sal-lejte ‘alâ ibrahîme ve ‘ala âli ibrahîme ve barik ‘ala muhammedin kemâ bârekte ‘ala ibrahime ve alâ âli Ibrahime inneke hamîdun mexhîd, rabbena âtina fi-dun‘ja hase-neten ve fil âhireti saseneten ve kinâ adhaben-nar”.

Përkthimi në gjuhën tonë: ”Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-rraxhim, Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim. Falënderimi i qoftë All-llahut - Zotit të botëve! Zot, tregoja mëshirën dhe qetësinë të Dërguarit më të zgjedhur. Zot, vetëm Ty të takon falënderimi. Vetëm Ty t‘i drejtoj lutjet e mia dhe përkushtimin fetar. Në duart Tuaja janë jeta dhe vdekja ime, Ty të kthehem. Ty të mbështetem nga brengat, pikëllimi, pafuqia dhe dembelia; Ty të mbështetem nga shpirtngushtësia dhe koprracia. O Zot! Më përforco në fe e cila më mbron, mi përmirëso dhuntitë e kësaj bote me të cilat jetoj; përmirësomi mundësitë e mia në botën tjetër. Mundëso që me vdekje të lirohem nga të gjitha ligësitë. Zot, të lutem për shëndet dhe përmirësim të fesë sime dhe gjendjes sime, familjes dhe pasurisë në këtë botë. Zot, mbuloje turpin tim dhe më mbro. Zot! Mi fal mëkatet, paditurinë dhe teprimet. Më fal për ate që kam kryer dhe do të kryej, nga ajo që kam thënë fshehurazi dhe haptazi. E që Ti e di më mirë se unë. Ti je i Gjithëfuqishëm! Zot! Të lutem për Xhennet dhe mbrojtje nga zjarri. Nuk ka zot tjetër përveç All-llahut. Ai është i vetmi, nuk ka shok. Vetëm Atij i takon sundimi dhe falënderimi. Zot! Mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij, ashtu siç mëshirove Ibrahimin dhe familjen e tij. O Zot, dhuroji dhunti familjes së Muhammedit ashtu siç iu dhurove familjes së Ibrahimit. Ty je i falënderuar dhe i madhëruar. Zoti ynë! Na jep mirësi në këtë dhe në botën tjetër dhe na ruaj nga zjarri i Xhehennemit- Amin.”

Gjatë qëndrimit në Arafat mirë është që të pendohemi dhe të bëjmë teube për veprat e këqija. Në një hadith të cilin e transmeton Bejhekiu, Muhammedi s.a.v.s. haxhilerët

i porosit që njëqind herë t‘i lexojnë këto tekste: Lâ ilahe illall-llahu vahdehû lâ sherîke leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ‘alâ kul-li shej‘in kadîr. Kul huvall-llahu ehad. All-llâhus-samed. Lem jelid ve lem jûled. Ve lem jekun-lehu kufuven ehad. All-llahumme sal-li ‘ala Muhammedin ve ‘ala âli Muhammedin kema sal-lejte ‘ala Ibrahîme ve ‘ala âli Ibrahîme inneke hamidun mexhîd.

Pesëmbëdhjetë minuta pas perëndimit të diellit, haxhilerët me autobusë, duke lexuar telbijje dhe tekbire nisen në drejtim të Muzdelifes, përkatësisht Mesh‘aril Haramit dhe Mines.

Kapitulli 27

Muzdelife

Kur të arrihet në Muzdelife, zbritet nga autobusët dhe në kohën e jacisë, së bashku falen namazi i akshamit dhe jacisë në formë të shkurtuar, me një ezan dhe dy kamete.

Zakonisht në Muzdelife mblidhen guralecët të cilët hidhen në Mine, madhësia e të cilëve duhet të jetë sa madhësia e lajthive të vogla. Këtu grumbullohen 49 guralecë.

Qëndrimi në Muzdelife deri në lindje të diellit të ditës së parë të Kurban Bajramit, sipas medh'hebit tonë është sunnet. Pas faljes së namazit duhet kryer ibadete të ngjashme sikur në Arafat. Kjo nënkupton që t'i drejtohemi All-llahut për mëshirë dhe falje. Pas kësaj me autobus shkohet në Mine ku do të vendosen haxhilerët në tendat e përgatitura për ta. Gjatë rrugës prej Muzdelifes për në Mine duhet lexuar telbijje.

Kapitulli 28

Minne - Dita e parë e Kurban-Bajramit

Pasi që të falet sabahu, haxhiu drejtohet në një nga tri vendet ku hidhen guralecët, në vendin e quajtur Akabe, apo siç i thonë në gjuhën e popullit, te shejtani i madh. Këtu, ditën e parë të Kurban Bajramit hidhen shtatë guralecë.

Pasi që të arrihet në Akabe, ndërpritet leximi i telbijjeve dhe guralecët hidhen në një shtyllë të caktuar ashtu që guri kapet me gishtin tregues dhe gishtin e madh dhe duke thënë "Bismilah Allahu ekber", hidhet drejt shtyllës.

Siç kemi përmendur më lartë, hidhja simbolike e guralecëve duhet kuptuar si shkëputje formale nga të gjitha veset negative të cilat njeriun e shpijnë kah veprat e ndaluara, haramet.

Kapitulli 29

Kurbani

Për haxhilerët që e kryejnë llojin e haxhit Temet'u dhe Kiran, pra llojet e haxhit që obligojnë therjen e kurbanit, në këto çaste, pas gjuajtjes së guralecëve të parë, në fabrika dhe vende të caktuara theren Kurbanet. Do të ishte e preferuar që haxhilerët të falin nga dy rekate nafile namaz në emër të Allahut për hir të kurbanit që theret. Ky namaz është sikur çdo namaz tjetër nafile, kurse nijetin e bëjmë kështu: "O Zot vendosa që në emër Tënd të fali dy rekate namaz të Kurbanit. Iu ktheva kibles, Allahu ekber".

Kapitulli 30

Ruajtja apo qethja e flokëve

Pas hedhjes së guralecëve dhe therjes së Kurbanit, haxhiu duhet rruar apo t'i shkurtojë flokët, e mustehab është që në të njëjtën kohë të priten edhe thonjtë. Me mbarimin e obligimeve në Mine haxhiu lirohet nga të gjitha ndalimet e përcaktuara me hyrjen në ihram, me përjashtim të marrëdhënieve intime me bashkëshorten. Kjo, përndryshe, quhet "et-tehâl-lulul-evvel" apo lirimi i parë nga obligimet.

Pasi që tavafi ditën e tretë dhe të katërt është më rëndë të kryhet për shkak të turmës së madhe të njerëzve, haxhiu më së miri e ka që qysh ditën e parë të zbresë në Mekke dhe ta kryejë Tavafi-zijareh, apo tavafin e haxhit, i cili është farz. Ky tavaf mund të kryhet edhe duke qenë në ihram (pra ende pa e larguar ihramin), por edhe nëse i kemi shkurtuar flokët dhe e kemi larguar ihramin. Në të dy rastet është e lejuar.

Kapitulli 31

Tavafi i haxhit

Haxhiu hyn në harem dhe lexon: "Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber, Bismilahi ves salatu ves selamu ala rasulil-lah. Eudhu bilahil adhim ve bivexhhihil kerim ve sulltanihil kadim minesh shejtani rraxhim. Allahume iftah lii ebvabe rahmetik... All-llahumme inni urîdu tavafe bejtike-l harame fejessirhu lî ve tekabbelhu minni etufu sab'ate eshvatin tavafe-z zijareh, bismilah All-llahu ekber".

Përkthimi në gjuhën shqipe: "Zoti im, dua ta bëj tavaf bejtul-Haremin; andaj ma lehtëso dhe ma prano. Tavafin e haxhit do t'i bëj shtatë rrotullime, bismilah All-llahu ekber".

Në çastin e fillimit të Tavafit, duhet që ndërtesën e Qabesë ta ketë në anën e majtë. Rrotullimi fillon që nga guri i zi dhe përfundon në gurin e zi. Kurse një tavaf përmban shtatë rrotullime. Kur të fillojë me çdo rrotullim, e puth gurin e zi nëse ka mundësi e nëse për shkak të grumbullit të madh të njerëzve nuk mund ta bëjë këtë, atëherë vetëm e drejton dorën e djathë drejt tij dhe thotë: "Bismil-lah, Allahu ekber. Bismil-lah, Allahu ekber. Bismil-lah, Allahu ekber".

Vendin prej ku duhet të fillojë me rrotullimin (tavafin), pra vendi se ku gjendet guri i zi, e sheh te këndi i Qabesë në anën e majtë, kurse nëse e kthen kokën në anën e djathtë, do të shohë një dritë të gjelbër të vendosur në mur lart.

Në rrotullimin e parë rreth Qabes, në gjuhën arabe lexohet: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmanen bike ve tessdîkan bi kitabike vefâen biahdike vet-tibâan li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sellem. Es-elukel afve vel afijete fid-dîni ved-dun'ja vel-âhireti vel feuze bil-xhenneti ven-nexhâte minen-nâri.

Që në gjuhën shqipe do të thotë: O Zot, e kryej këtë vepër duke u bazuar në besimin tim ndaj Teje, dhe duke e përforcuar besimin në librin Tënd dhe duke e plotësuar premtimin ndaj Teje dhe duke e praktikuar sunetin e pejgamberit tënd dhe të dashurit tënd, Muhamedit salallahu alejhi ve sel-lem, të lutem për falje, shëndet dhe fuqi në fe, në këtë botë dhe në botën tjetër ta arrijë xhennetin dhe shpëtohem nga zjarri.

Rrotullimi i parë

Në rrotullimin e parë, të dytë dhe të tretë, ihrami duhet të jetë në atë mënyrë që supi i djathtë të jetë i pambuluar ndërsa i majti i mbuluar.

Haxhiu shpejton gjatë kryerjes së tri rrotullimeve të para, kurse ec normal gjatë katër rrotullimeve të fundit. E prek me dorë këndin e Jemenit, natyrisht nëse i jepet mundësia, sa herë që kalon afër tij, por nuk e puth e as nuk bën shenjë nga ai.

Kur të arrihet në këndin e tretë të Qabes, te këndi i ashtuquajtur këndi i Jemenit, me dorë do të tregojmë kah ai dhe do të themi: "All-llahu ekber" dhe, deri në këndin e katër të Qabes, në të cilin gjendet Haxherul-esvedi, duhet lexuar: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nari, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Kur të arrihet te Haxherul-esvedi, duke u drejtuar kah ai thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Dhe, duke treguar kah Haxherul-esvedi thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Rrotullimi i dytë

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâen bi'ahdike vettibâ'an li sunneti nebi-jjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim, e'udhu bike minen-nari fe harrim luhumena ve besheretena alen-nâri, All-llahumme hadhelbejtu bejtuke fe habbib ilejne-l îmâne ve zejjin bihi kulubena ve kerrih ilejnel kufra vel fusuka vel isjâne ve xhealna minerrashidîn.

Apo, në gjuhën tonë: "Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muham-medit s.a.s, kërkoj mbrojtjen Tënde nga zjarri dhe ndaloja zjarrit djegien e mishit dhe fytyrave tona. O Zot, kjo shtëpi është e Jotja, na e bën imanin të dashur dhe zbukuroje atë edhe më shumë në zemrat tona. O Zot na mundëso t'a urrejmë kufrin dhe mëkatin (mosbindjen) dhe na udhëzo".

Në këndin e Jemenit të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër, ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nari, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Me të arritur te Haxherul-esvedi, duke i drejtuar duart thuhet: "Bismi-lahi, All-llahu ekber".

Rrotllimi i tretë

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ‘en bi‘ahdike vettiba‘an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lem, e‘udhu bike minesh-shekki ve-sh-shirki ve-n-nifaki ve suil-mendheri ve-l menkalebi fi-l mâli vel ehli ve-l veledi, All-llahumme inni es‘eluke ridake ve-l xhennete ve u‘udhu bike min sehtike ve-n-nari, e‘udhu bike min kul-li ma jueddi ile-l adhâbi.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të mbështetem nga dyshimi shirku, dyfytyrësia, morali i ligë, pamja e keqe dhe ndryshimet e këqija në pasuri dhe familje. O Zot, lus për kënaqësinë Tënde dhe Xhennetin. Të mbështetem nga zemërimi dhe zjarri. Të mbështetem nga gjithçka që shpie në mundime”.

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: ”All-llahu ekber”, dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun‘ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina ‘adhaben-nar, ved‘hilnel xhennete me‘al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

”Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!”

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: ”Bismil-lahi, All-llahu ekber”.

Rrotullimi i katërt

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme imanen bike ve tesdikan bi kitabike ve vefâ‘an bi‘ahdike vettibâan li sunneti nebi-jjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lem, es‘eluke en texh‘ale min zijâretî

hadhihi haxhxhen mebru-ren ve dhenben megfuren ve amelen sâlihan makbulen, jâ alimel gujubi veh‘rixhni jâ All-llahu minedh-dhulumâti iilen-nuri All-llahum-me innî es‘eluke rahmeteke ve-s-selamete min kul-li ithmin rabbî kanni‘nî bimâ razektenî ve bârik fîmâ e‘atejtenî.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të lutem që ta pranosh vizitën time, haxhxhin tim, të na falësh gabimet (dhe të na i zëvendësosh) me vepra të mira. O Njohës i sekretit! Më nxjerrë nga errësira në dritë. O Zot! Të lus për mëshirën dhe shpëtimin Tënd nga mëkatet. O Zot! Më bën të kënaqur me atë që më furnizove dhe begatoje atë që ma dhurove”.

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: ”All-llahu ekber”, dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fiddun‘ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina ‘adhaben-nar, ved‘hilnel xhennete me‘al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

”Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!”

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: ”Bismil-lahi, All-llahu ekber”.

Rrotullimi i pestë

Në gjuhën arabe lexohet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmânen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ‘an bi‘ahdike vettibâ‘an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim. Es-eluke en tudhal-lileni fî dhillike jeume lâ dhil-le il-lâ dhil-luke, All-llahumme inneke ta‘lemu sirrî ve alâ nijeti fekbel me‘dhirati ve te‘lem hâxhetî fe‘tini suûlî. All-llahumme mâ âlimtu minhu ve ma lam e‘lemu.

”Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty

duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u,, të lutem që të më marrësh në hijen Tënde, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër. Vërtetë Ti i di sekretet e mia dhe gjërat publike, andaj pranoje arsyetimin tim. Ti i di nevojat e mia, andaj plotësona kërkesat. O Zot! Të mbështetem nga të gjitha fatkeqësitë e tashme dhe ato të ardhshme të cilat nuk i di."

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fiddun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nar, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Rrotullimi i gjashtë

Në gjuhën arabe bëhet kjo dua: Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme imanen bike ve tesdikan bi kitabike ve vefâ'en bi'ahdike vettibâan li sunneti nebijjike ve habîbike muhammedin sal-la-llahu alejhi ve sel-lim. Es'eluke en testure auretî, All-llahumme inne leke 'alejje hukukan kethîreten fîmâ bejnî ve bejneke ve hukukan kethireten fîma bejnî halkike, All-llahumme mâ kâne leke min'ha fag'firha lî ve mâ kâne lihalkike fetehammelha annî. All-llahumme inne bejteke hadha adhîmun ve ente halîmun ve tuhibbul afve fa'fu anni.

"Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke besuar në Ty duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd Muhammedit u, të lutem të ma mbulosh turpin tim (mëkatet). O Zot! Në relacion ndërmjet meje dhe Teje, të kam mjaft borxh, e gjithashtu kam mjaft borxh ndërmjet meje dhe krijesave Tua. O Zot! Për të

drejtën Tënde më fal. E për të drejtën e krijesave Tua merr nga unë (si borxh tëndin). E Jotja është kjo Shtëpi madhështore, e Ty je i Mëshirshëm dhe e do faljen, andaj më fal!"

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fiddun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nar, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismillahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Rrotullimi i shtatë

Në gjuhën arabe bëhet kjo dua: "Bismil-lahi, All-llahu ekber, All-llahumme îmanen bike ve tesdîkan bi kitâbike ve vefâ'en bi'ahdike vettibâ'an li sunneti nebijjike ve habîbike Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lim. Es'eluke-l-magfirete verrahmete. All-llahumme en'im alejje imânen kâmilen ve rizkan vasian ve kalben hâshian ve sihhaten ve âfijeten ve teubeten kablel meuti ve ledhete-n-nedheri ilâ vexh'hike jâ erhamerrahimiîn. All-llahumme thebbit kulubenâ alâ dînike veel hiknî bis-salihîne".

"Bismil-lahi, All-llahu ekber! O Zot! Duke të besuar Ty dhe duke vërtetuar Librin Tënd, duke kryer obligimin Tënd dhe duke ndjekur sunnetin e të Dërguarit Tënd - Muhammedit u, të lutem për falje dhe mëshirë. O Zot, ma dhuro dhuntinë e imanit të plotë, furnizim të bollshëm, zemër të penduar, shëndet, teube (pendim) para vdekjes dhe kënaqësinë që të të shoh Ditën e Gjykimit, o i Mëshirshmi. O Zot, na e përforco zemrën në fenë Tënde dhe më bashko me njerëz të mirë."

Kur të arrihet në këndin jemenian të Qabes, duke u drejtuar kah ai thuhet: "All-llahu ekber", dhe deri në këndin e

katër ku gjendet Haxherul-esvedi, lexohet: Rabbena âtinâ fid-dun'ja haseneten ve fil âhireti haseneten ve kina 'adhaben-nar, ved'hilnel xhennete me'al ebrari, jâ azîzu, ja gaffaru, bismil-lahi, All-llahu ekber.

"Krijuesi ynë! Na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër; na ruaj nga zjarri dhe na fut në xhennet me të drejtët, o i Madh dhe i Mëshirshëm!"

Duke treguar kah haxherul-esvedi, thuhet: "Bismil-lahi, All-llahu ekber".

Kapitulli 32

Namazi i tavafit

Pas kryerjes së tavafit, haxhiu do të gjejë ndonjë vend të përshtatshëm që t‘i falë dy reqate namaz të tavafit të cilat janë vaxhib. Më së miri është që ato t‘i falë pas Mekami Ibrahimit, mirëpo kjo në kohën e sotshme, është e pamundshme të falim në këtë vend dy reqatë e mos t‘i pengojmë haxhilerët tjerë.

Këto dy reqatë bëhen nijet kështu: ”Nevejtu en usal-li lillahi te‘ala rek‘atejni tavafi mustekbilel kibleti. All-llahu ekber”.

”Vendosa, në emër të All-llahut, duke u drejtuar kah Kibla, t’i falë dy reqate të tavafit, All-llahu ekber.”

Në reqatin e parë, pas subhanekes dhe Elhamit, lexohet sureja el-Kafirune (Kul-ja ejjuhel-kâfirun), e në të dytin pas el-Fatihas lexohet sureja Ihlas (Kul-huvall-llahu).

Kur të jepet selam, zakonisht duke u kthyer kah Kibla, lexohet duaja: All-llahumme jâ rabbel bejtil atîki i‘tik rikâbena ve rikâbe âbâinâ ve ummehatinâ ve ihvaninâ minen-nari. All-llahumme inni ‘abduke vâkifun emâme bejtike mutedhel-lilun bejne jedejke erxhû rahmeteke ve ehshâ adhâbeke jâ kadîmel ihsani. All-llahumme innî es‘eluke en tukavvije îmânî ve teda‘a vizri ve tusliha emrî ve tutahhira kalbî ve es‘elukel xhennete. Amin.

Ja përkthimi: ”O Zot i Qabes! Na shpëto nga zjarri,

prindërit, nënat, vëllezërit dhe fëmijët tanë. O Zot, vërtetë unë jam robi Yt dhe qëndroj para Shtëpisë Sate, i përkulur lus për mëshirën Tënde. Frikohem nga ndëshkimi Yt, o Mirëbërës i Gjithmonshëm. O Zot! Vërtetë të lutem ta përforcosh imanin tim, të ma shkarkosh barrën, të ma përmirësosh gjendjen dhe të ma pastrosh zemrën. Të lutem për Xhennet - Amin."

Kapitulli 33

Uji Zemzem

Edhe kësaj radhe, sikur pas çdo tavafi, është e preferuar të pihet nga uji i zemzemit. Rregullat e pirjes së këtij uji janë sikur potencuam më lartë. Për informata më të gjëra, lexo në faqen 45.

Kapitulli 34

Sa‘ji i haxhit

Haxhiu përgatitet për sa‘jin ashtu siç parapërgatitet për namaz (pra me abdes dhe me veshje të pastra). Sa‘j quhet ecja e shpejtuar e cila fillon nga Safa, bregu i vogël i cili gjendet diku rreth 50 m nga Qabeja, dhe zgjatë deri në Merve, në bregun tjetër shkëmbor. Ndërmjet këtyre dy brigjeve, të cilat sot janë në përbërje të Haremit, ka 375 m. Kalimi prej Safasë deri në Merve konsiderohet një qark, kurse prej Merves në Safa, i dyti dhe ashtu vazhdojmë shtatë herë. Në këtë rrugë, ndërmjet dy shtyllave të shënuara, ndërmjet të cilave ka diku rreth 80 m, duhet ecur me vrap. Ky vrap për gratë nuk është obligativ.

Më parë është e nevojshme që në Safa ta bëjmë nijetin e sa‘jit. Nijeti në gjuhën arabe bëhet në këtë mënyrë:

”All-llahumme innî urîdu en ess‘â bejnes-safâ vel merveti seb‘ate eshvatin seâjel haxhxhi lil-lahi teâla fejessirhu lî ve tekabbelhu minni. All-llahu ekber. All-llahu ekber. All-llahu ekber”.

Ose përkthimi në gjuhën tonë: ”O Zot! Dëshiroj që në emrin Tënd ta kryej sa‘jin ndërmjet Safasë dhe Merves shtatë herë, në emër të sa‘jit të haxhit, andaj ma lehtëso dhe ma prano kryerjen. All-llahu ekber, All-llahu ekber, All-llahu ekber”.

Pasti hyjmë në sa’j, duke pasur parasysh se ecja e shpejtuar

e vështirëson frymëmarrjen, nuk kemi mundësi që të lexojmë shumë, mirëpo gjatë këtij rasti është mirë të lexohet duaja e kunutit, të cilën të gjithë e dimë, e pastaj duhet të lexohet edhe ky ajet: Bismil-lahirr-Rrahmanirr-Rrahim. Innes-safâ vel mervete min sheâiril-lahi, femen haxhxhel bejte eu i'temere felâ xhunâha 'alejhi en jettavvafe bihima ve men tetavve'a hajren fe innall-llahe shâkirun 'alîm.

Që në gjuhën shqipe do të thot: "Safa" dhe "Merve" janë nga shenjat (për adhurim) e All-llahut, e kush e mësyn shtëpinë për haxh (Qaben për haxh), ose për umre (vizitë jashtë kohës së haxhit), nuk është mëkat për te t'i vizitojë ato dyja (të ece në ato dy vende). E kush bën ndonjë të mirë nga vullneti (jo obliguese), s'ka dyshim se All-llahu është shpërblyes i gjithëdijshëm.

Pasi që të kalohet largësia ndërmjet Safasë dhe Merves shtatë herë, duke e kënduar për çdo herë duanë e kunutit (Allahume inna nesteinuke dhe Allahumme ijjake) dhe ajetin e lartpërmendur, haxhiu do të ndalet në Merve, mbasi hera e shtatë përfundon në këtë breg, atëherë është mirë që haxhiu ta lexojë këtë dua: El-hamdu lil-lahi rabbil 'alemîn vessalâtu ves-selâmu 'ala Muhammedin ve 'ala âlihi ve as'habihi exhmeîn. Rabbena tekabbel minnâ hadhihil ibâdete ve'afu annâ ve alâ tâ'atike ve shukrike e'innâ ve alel îmani vel islâmil kâmili teveffena ve ente râdin annâ. All-llahumme irhamnî bi terkil me'âsî ebeden ma ebkajteni verhamnî in lâ etekel-lefe mâ lâ ja'nînî verzuknî bimâ jurdîke annî. Jâ erhamerr-rrahimin.

Përkthimi në gjuhën tonë: "Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve, mëshira dhe shpëtimi qoftë mbi Muhammedin, familjen dhe shokët e tij. O Zoti ynë, pranoje këtë ibadet prej nesh dhe na falë. Na ndihmo që të jemi të dëgjueshëm dhe falënderues dhe dua të jesh i kënaqur me ne. Na mundëso vdekjen me iman të plotë dhe Islam. O Zot, më mëshiro që gjithmonë ta flak mosdëgjueshmërinë ndaj Teje, derisa të jem gjallë. Më falë (ashtu që) të mos jem i ngarkuar me atë që nuk më intereson. Më furnizo me ato me të cilën do të jesh i

kënaqur, o i Gjithëmëshirshëm!”

Me kryerjen e sa‘jit të haxhit nuk mund të themi se e kemi kryer haxhin, por kushtet kryesore të haxhit, po. Më pas na mbetet edhe gjuajtja e guralecëve të dytë dhe tretë dhe tavafi i lamtumirës.

Kapitulli 35

Gjuajtja e guralecëve të dytë - Dita e dytë e Kurban-Bajramit

Ditën e dytë të Bajramit, kur dielli është në zenit, pra në mes, haxhiu do të hedhë guralecë, për dallim nga dita e parë, në tri vende nga shtatë gurë.

1. Së pari në xhemren e parë (pra në shejtanin e vogël)
2. Mandej në xhemren e dytë, 155 me larg nga e para (pra në të mesmin)
3. Në shtyllën e tretë (Akaben) rreth 150 m larg nga e dyta (pra në shejtanin e madh).

Gjatë hedhjes së guralecëve në Akabe veprohet njëlloj sikur në ditën e parë të Kurban-Bajramit. Kjo hedhje ditën e dytë mund të kryhet prej zenitit të ditës së dytë deri në perëndimin e diellit të ditës së njëjtë.

Kapitulli 36

Gjuatja e guralecave të tretë - Dita e tretë e Kurban-Bajramit

Ditën e tretë të Kurban-Bajramit në të njëjtën kohë përsëriten veprimet e ditës së dytë. Me këtë kryhen të gjitha obligimet në Mine.

Duke pasur parasysh se Mina është vend mjaft i ngushtë, pjesa dërmuese e haxhilerëve zbresin në Mekke qysh ditën e parë të Bajramit dhe përqendrohen në hotel. Personat që dëshirojnë të dalin në Minne këto dy ditë, duhet të paraqiten te udhëheqësit e tyre dhe atyre iu mundësohet ky akt.

Duhet theksuar edhe atë se gjatë kryerjes së këtij obligimi (hedhjes së guralecëve), haxhiun për shkaqe objektive dikush mund ta zëvendësojë, si p.sh. sëmundja, pleqësia e thellë, pamundësia, shtatzënia dhe ngjashëm. Në këtë rast i autorizuari së pari do ta kryejë obligimin për vete e mandej për atë që e zëvendëson.

Kapitulli 37

Tavafi i lamtumirës - Veda

Sipas medh'hebit tonë, tavafi i lamtumirës i cili kryhet para se të largohemi nga Mekka është vaxhib, mirëpo pasi të kryhet tavafi i lamtumirës është mustehab që menjëherë të largohemi prej Mekkes.

Me kryerjen këtij tavafi, pra që e kuptojmë edhe nga emri i tij, përshëndetemi me Qabenë dhe bëjmë duanë e fundit para Qabesë, edhe njëherë dëshirojmë faljen dhe mëshirën e Alllahut dhe dalim nga Haremi.

Nuk ka nevojë siç thonë disa, që nga Haremi të dilet duke ecur së prapthi, kinse kjo qenka mustehab, ngase për këtë nuk kemi argumente se ashtu ka vepruar Muhammedi s.a.v.s., por përkundrazi duhet të kemi kujdes të mos i shqetësojmë haxhilerët e tjerë, ngase Haremi është përplot haxhilerë.

Përfundimi

Së fundi dëshiroj dhe lutem që Allahu i Fuqishëm ta ketë pranuar nga ne këtë ibadet të madh. Ngase ju përfunduat me haxhin, ngadalë duhet të ndaheni edhe nga shumë shokë dhe vllezër që më parë nuk i njihnit fare kurse tash ju duket se gjithmonë i keni njohur. Shpresoj dhe lutem që kjo formë e sqarimit përmes kësaj broshurës dhe ata që e kanë pranuar edhe sqarimin e haxhit përmes zërit, ju ka ndihmuar dhe lehtësuar kryerjen e haxhit.

Së fundit, në emër të kolegëve dhe në emër të grupit organizativ të ju bëj për hajr haxhin.

Allahu na grumbulloftë së bashku afër Pejgamberit a.s. në xhenet,

Vesselamu Alejkum ve rahmetullah,

Përgatiti dhe lexoi:
Bekim Alimi - Imam në xhaminë Wil / SG